



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:102736

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05664068

**P.nr. 121/2024**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-Dega Viti, Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtarës Blerina Jakupi Ramadani, me bshkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, duke vendosur në çështjen penale të pandehurit M.B.nga Vitia rr. "N.K., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafin 1 lidhur me paragrafin 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.315/2024, të datës 29.03.2024, me kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 08.05.2024, mori këtë:**

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr. 315/2024 të datës 29.03.2024 e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm dhe gjykata jep, këtë:

### U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I pandehuri **M.B.**, nga babai SH., nëna SH., e vajzëris S., i lindur me dt. ,,., në GJ., me vendbanim në Viti, rruga ,, N.K., ka të kryer shkollën fillore, me gjendje ekonomike të dobët, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ....., lëshuar nga MPB-Prishtinë.

### Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse, nga data e pa vërtetuar e deri me datën 01.02.2024, në shtëpin e tij, në Rr."Flaka e Janarit", p.n., në Viti, i pandehuri M.B., ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shërbim të kompensimit dhe ka shmang pagesën, ashtu që, pas kontrollës që i është bërë nga zyrtarët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se, i pandehuri ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, jashtë pikës matëse të njësorit elektrik dhe ka shpenzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, duke i'u shmangur regjistrimit dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 287.39 Euro.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 43 të KPRK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, të pandehurit të lartcekur:

## **I SHQIPTON** **Denim me gjobë**

Ashtu që të pandehurit M.B.për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro), të cilin denim i pandehuri do ta paguaj në afat në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) € të dënimit me gjobë.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Gjilan udhëzohet që kërkesën pasurore juridike t'a realizoj në kontest të rregullt civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 03.04.2024 në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në Viti ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.315/2024 të dt.29.03.2024, ndaj të pandehurit M.B.nga Vitia, Rr.,N.K., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe komfor nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit M.B., t'i shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali me numër 2143564 i datës 01.02.2024, Kalkulimi i rikthimit të humbjeve, me numër 506436, i datës 05.02.2024, fatura me numër DGLHP2413851 e datës 20.02.2024, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici dhe fotoja nga vendi i ngjarjes, si dhe shkresat tjera janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues, andaj bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Andaj, bazuar në të lartë cekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm RH, të cilën e bën vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-ës, të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 par. 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega Viti**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr. 121/2024, datë 08.05.2024**

**Gj y q t a r j a,**  
**Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtares individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.